

MUHAMED ALI ES-SABUNI

**DYSHIMET DHE TË PAVËRTETAT
RRETH SHUMËSISË SË GRAVE
TË PEJGAMBERIT A.S.**

Logos-A

MUHAMED ALI ES-SABUNI

***DYSHIMET DHE TË PAVËRTETAT
RRETH SHUMËSISË SË GRAVE TË
PEJGAMBERIT A.S.***

Logos-A, Shkup
1418/1998

Titulli i origjinalit

شبهات وأباطيل
حول:
تعدد زوجات الرسول ﷺ

بشم
محمد علي الصابوني

Përktheu
Muhamed Osmani

Redaktor
Ymer Musa

CIP – Katalogizacija i publikacija Narodna i
Univerzitetska biblioteka “Kliment Ohridski” – Skopje

297.164 Muhamed
929-055.2:297.164 Muhamed

ALI es-Sabuni, Muhamed

Dyshimet dhe të pavërtetat rreth shumësisë së grave të Pejgamberit a.s. /
Muhamed Ali es-Sabuni ; [përktheu Muhamed Osmani]. – Shkup : Logos-A,
1419/1998. – 40 str. : 20 cm. – (Biblioteka Mendimi Islam)

Nasl. na izvornikot na arap. jazik

ISBN 9989-601-80-1

l. Osmani Muhamed

a) Muhamed (570-632) – Soprugi b) Sopruginë Muhamed – Biografi

Muhamed Ali es-Sabuni

***DYSHIMET DHE TË PAVËRTETAT RRETH
SHUMËSISË SË GRAVE TË PEJGAMBERIT A.S.***

HYRJE

Falënderimi i qoftë All-llahut xh.sh, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi Muhammedin a.s., familjen dhe shokët e tij, si dhe mbi ata që pasuan rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Ju përshëndes me përshëndetjen islame: “Përshëndetje nga Perëndia, e begatshme dhe e mirë”

E lus All-llahun xh.sh. të na i bashkojë zemrat tona në dashurinë e Tij dhe me atë me çka është i kënaqur dhe e lus që të na dhurojë sukses e suksessitet, besnikëri në fjalë dhe në punë, të na furnizojë me besim të plotë dhe bindje të vërtetë, se me të vërtetë Ai dëgjon gjithçka dhe është pranues i lutjeve tona.

VËLLEZËR TË DASHUR

A e vëren shkëlqimin e Diellit rrezeartë në mesditë? Dritën e tij nuk e pengon kurrfarë pengese, nuk e mbulojnë retë ose diç tjetër, e nëse dikush dëshiron t’ia shuajë dritën ose ta mbulojë shkëlqimin e tij po që se e frynë me gojën e tij apo ia hedh një pelerinë, a do t’ia arrinte qëllimit që ta humbë shkëlqimin e tij? Jo, jo. Gjithashtu, Dielli ynë për të cilin do të flasim në këtë

mbrëmje të shkurtë,¹ assesi nuk shuhet dhe nuk humbë. Nuk do të flasim zotërinj për Diellin e qiellit por për Diellin e tokës. Nuk do të flasim për Diellin që djeg por për Diellin që dritë. A e dini kush është ai diell? Ai është Dielli i peygamberisë dhe i udhëzimit, është dritë shkëlqyese dhe kandil ndriçues, që me të All-llahu xh.sh. i nxori njerëzit prej errësirës në dritë. Ai është Muhammedi a.s., Peygamberi besnik dhe i ndershëm.

E vërtetë është fjala e All-llahut xh.sh. kur thotë:

“Ata dëshirojnë ta shuajnë dritën e Perëndisë me gojën e tyre. E Perëndia e përsosë dritën e vet, edhe nëse e urrejnë mohuesit. Perëndia është Ai që ka dërguar profetin e Vet me udhëzim për rrugën e drejtë dhe fenë e vërtetë, për ta ngritur më lartë se të gjitha fetë, edhe nëse e urrejnë të pafetë.” (Saff-8)

Ky pra është Dielli i tokës për të cilin do të flasim në këtë mbrëmje. Për këtë All-llahu xh.sh. me një përshkrim të mrekullueshëm në Kur'an thotë:

“O Peygamber. Ne të kemi dërguar si dëshmitar dhe si sihariq, si paralajmërues dhe thirrës (në rrugën e drejtë) te Perëndia-me urdhrin e Tij që të jeshë kandil ndriçues.” (Ahzab-45-46)

Ky kandil nuk është diç tjetër vetëm se Dielli i peygamberisë i cili shkëlqen me dritën e tij çdo gjë, andaj edhe panë ata që shohin, ndërsa e mohuan këtë dritë të

¹ Kjo ligjëratë është mbajtur në rezidencën e Rabitas në Mekken e nderuar drejtuar delegacioneve të haxhilerëve në mbrëmjen e ditës së hënë të javës së parë të dhilhixhës në vitin 1390 hixhrij, 1970 miladij.

verbërit dhe të humburit. Për Zotin, sa fjalë e mirë është fjala e një poeti ku thotë:

*Dhe dielli ynë në qiell,
krenar ndriçon
kurse verbësia e qorrave
aspak se dëmton*

Shumë herët armiqtë e Islamit nxitnin dyshime për Pejgamberin a.s. dhe urrejtje në pejgamberinë dhe fisnikërinë e tij. Shpifnin gënjeshtër e mashtrime, vetëm e vetëm që të muslimanët të nxitnin hamendje në fenë e tyre dhe t'i largojnë nga besimi në pejgamberinë e Muhammedit a.s. Nuk është çudi kur dëgjojmë lloj-lloj shpifjesh dhe të pavërteta rreth Pejgamberëve alejhi-musselam, sepse ky është ligji i All-llahut xh.sh. në krijesat e Tij. Ne në ligjet e Tij nuk mund të hasim kurrfarë ndryshimi. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Dhe kështu Ne çdo Pejgamberi ia kemi vënë armiqtë mohues. E, ty të mjafton Zoti yt-udhërrëfyes dhe ndihmës. (Furkan-31).

Para se të flasim për nënat e pastra të besimtarëve dhe shkakun e martesës së Pejgamberit a.s. me to, duhet pikësëpari të reagojmë ndaj një shpifjeje të marrë, meqë e kanë trilluar armiqtë krishtere urrejtës dhe Perëndimi fanatik.

Ata shpeshherë e përsërisin këtë shpifje me qëllim të prishjes së besimit dhe shkeljes së të vërtetës, dhe që bartësi i Shpalljes madhështore, Muhammedi, i biri i Abdull-llahut, të nënçmohet.

Ata thonë: “Muhammedi ka qenë i dhënur pas epshit, shkante pas dëshirës dhe kënaqësive të tij dhe

vepronte nën ndikimin e epshit të tij. Nuk i mjaftoi një grua apo katër si çdo pasuesi të tij, por u martua dhjetë e më tepër herë, sikur ia donte epshi dhe dëshira.” Gjithashtu thonë: “Ekziston dallim i madh ndërmjet Isaut dhe Muhammedit, dallim mes atij që e zotëronte dhe e luftonte epshin e vet si Isau, biri i Merjemes, dhe mes atij që shkonte sipas dëshirës dhe epshit të tij, si Muhammedi.”

“Është fjalë e madhe (e shëmtuar) që del nga goja e tyre. Ata flasin vetëm gënjeshtër.” (Kehf-5)

Vërtet, ata janë urrejtës dhe gënjeshtarë, sepse Muhammedi a.s. nuk ka qenë i dhënë pas epshit, por i dërguar nga mesi njerëzor. Është martuar si çdo njeri që të jetë shembull në ndjekjen e një rruge të njëjtë. E ai nuk është as Zot e as bir i Zotit, siç besojnë krishterët për Isaun a.s. Ai (Muhammedi) a.s. është njeri sikur ata, por të cilin All-llahu e veçoi me shpallje dhe peygamberi.

“Thuaj, unë jam vetëm njeri si ju, mua më është dërguar shpallja” (Kehf-110).

Peygamberi nuk ka qenë i veçuar nga peygamberët tjerë e as që e ka kundërshtuar rrugën e tyre. Për peygamberët a.s. flet Kur’ani me fjalët e All-llahut xh.sh. kur thotë: *“Ne me të vërtetë edhe para teje kemi dërguar peygamberë dhe u kemi dhënë gra dhe pasardhës.”*

Vallë, si mund të trillohen këso marrina për vulën e peygamberëve, por si thotë poeti:

*“Nuk është çudi
i verbëri ta mohojë*

*dritën e diellit.
Nuk është çudi
i sëmuri ta mohojë
shijen e ujit.”*

E vërtetë është fjala e All-llahut xh.sh. kur thotë:

“Me të vërtetë, nuk i kanë sytë e verbër (në këto gjëra), por janë të verbëta zemrat e tyre që i kanë në krahëror.” (Haxh-46)

Vëllezër të ndershëm!

Për ta shmangur këtë dyshim ekzistojnë dy pika me rëndësi që ia mbyllin gojën çdo shpifësi të pashpirt, të cilët dëshirojnë ta njollosin bartësin e Shpalljes, Muhammedin a.s. Andaj, nuk duhet t’i lëmë pas dore këto dy pika, e sidomos duhet të jemi syçelë kur bisedojmë për nënat e besimtarëve dhe urtësinë e martesës me to. Zoti qoftë i kënaqur me to.

Ato dy pika janë:

1. Pejgamberi – nuk e shtoi numrin e grave, vetëm atëherë kur ai hyri në moshën e pleqërisë-pra pas të pesëdhjetave.
2. Të gjitha gratë e tij të pastra ishin të veja, përveç Aishesë r.a. e cila ishte beqareshë.

Përmes këtyre dy pikave në mënyrë të thjeshtë mund të kuptojmë pabazën e kësaj akuze, dhe kotësinë e këtij pretendimi që ia etiketuan Resulull-llahut orientalistët urrejtës. Po të ishte qëllimi i martesave të tij lëshimi pas epshit apo plotësimi i dëshirës ose vetëm kënaqja me gra, ai me siguri do t’i martonte në moshën rinore e jo në pleqëri dhe do të martonte beqaresha e jo

gra të veja e të moshuara. Ai ishte që i tha Xhabirit, të birit të Abdullahut, kur erdhi te ai, e në fytyrën e tij vërehej gëzimi: **“A u martove?”** Tha: **“Po.”** I tha: **“Beqare apo të vejë?”** I tha: **“Të vejë.”** Pejgamberi a.s. atëherë i tha: **“Po të kishe martuar një beqareshë, do të luaje me të e ajo do të luante me ty, do të qeshje me të e ajo do të qeshej me ty.”**

Pejgamberi a.s. me këtë rast i propozoi martesën me beqareshë, meqë ai e dinte mirë mënyrën e kënaqjes dhe rrugën e dëshirës, dhe a është e logjikshme që dikush të martohet me gra të veja e t'i lë beqareshat, të martohet në moshë të shtyrë e ta lë moshën e re, nëse ka për qëllim kënaqjen e epshit? Shokët e tij do të flijonin me mish e me shpirt dhe po të kërkonte prej tyre ta martonin me ndonjë vashë të re e beqare, ata nuk do t'ia vononin aspak. Shtrohet pyetja: Pse Pejgamberi a.s. nuk u martua me shumë gra në moshë të re dhe pse nuk u martua me beqaresha por me gra të veja? Pa dyshim se ky qëndrim hedh poshtë çdo thashetheme dhe shpifje, shfuqizon çdo dyshim dhe trillim të ndonjë iftiraxhiu të poshtër, i cili dëshiron ta zhvlerësojë shenjtërinë e Muhammedit a.s. dhe ta njollosë autoritetin e tij të pastër.

Martetat e Muhammedit a.s. nuk bëheshin për shkak të epshit apo dëshirës, por për arsye të rëndësishme, qëllime të pastra dhe synime të larta, të cilat armiqtë e Islamit do t'i pranonin si të pastra e të larta po që se i lënë anash fanatizmin dhe verbërinë e tyre dhe gjykojnë me logjikë të pastër e arsye të shëndoshë. Ata në këto martesa do të gjejnë shembullin më të lartë në njeriun e ndershëm dhe fisnik, dhe Pejgam-

berin e mëshirshëm i cili sakrifikonte rehatinë e tij për interesat e popullit dhe interesin e thirrjes në Islam.

QËLLIMI I MARTESËS SË MUHAMMEDIT A.S. ME SHUMË GRA

Qëllimet për martesën me shumë gra të Muhammedit a.s. janë të shumta, por ne do t'i veçojmë disa nga ato:

1. Qëllimi arsimor
2. Qëllimi legjislativ
3. Qëllimi social
4. Qëllimi politik

Për çdo qëllim do të flasim shkurtimisht, e më vonë, me ndihmë të Zotit xh.sh., do të flasim edhe për nënat e pastra të besimtarëve dhe shkakun e martesës me çdonjërin nga ato.

1. QËLLIMI ARSIMOR

Qëllimi thelbësor i martesës me shumë gra ishte kualifikimi i një grupi mësuesesh të grave, të cilat do t'ua mësonin grave rregullat themelore të Sheriatit. Gratë përbëjnë gjysmën e shoqërisë. Atyre u është bërë obligim çka u është bërë obligim edhe burrave. Shumë prej tyre turpëroheshin ta pyesnin Muhammedin a.s. për disa rregulla islame, sidomos për çështjet që i përkasin

natyrës së tyre etj. Ato i kaplonte turpi kur dëshironin ta pyesin Pejgamberin a.s. për këto rregulla.

Po ashtu edhe si virtyt i Muhammedit a.s. ishte turpi i madh. “Pejgamberi”, siç transmetojnë librat e Sunnetit, “ka qenë më i turpshëm se beqaresha në dhomën e nusërisë.” Ai nuk kishte mundësi që në mënyrë të qartë t’i përgjigjej çdo pyetjeje që i parashtrohej nga ana e grave kështu që nganjëherë përdorte alegorinë, por disa nga gratë nuk arrinin ta kuptonin se ku e kishte qëllimin Pejgamberi a.s.

Aisheja r.a. transmeton se një grua prej ensarëve e pyeti Pejgamberin a.s. për pastrimin nga të përmuajshmet (hajzi). Pejgamberi a.s. e mësoi se si të pastrohet dhe shtoi duke i thënë: **“Merre një copë pambuk të parfymosur dhe pastrohu me të.”** Ajo i tha: “Si të pastrohem me të, o I dërguari i Zotit”? I tha: **“Pastrohu me të.”** Ajo përsëri e pyeti: “Si të pastrohem me të, o I dërguari i All-llahut.” Ai i tha asaj: **“Subhanallah, pastrohu me të.”** Thotë Aisheja: “Ia mora asaj pambukun prej dore dhe i thashë: “Vendoje në këtë vend dhe ki vëmendjen ndaj njollave të gjakut”, dhe ia shpjegova asaj vendin se ku duhet ta vejë atë. Me siguri se Pejgamberi a.s. turpërohej të shprehej haptazi, por gjithashtu edhe prej grave kishte shumë pak që e zotëronin vetveten dhe turpin dhe t’ia qartësojnë pyetjen lidhur me atë që u interesonte, ashtu që Pejgamberi alejhis-selam detyrohej të kërkonte sqarim më të madh për pyetjen e shtruar.

Ta marrim si shembull hadithin e Ummi Selemes, e që është transmetuar në dy Sahihët (Buhari dhe Muslim), ku thotë: “Erdhi Ummi Sulejmi (gruaja e Ebu Talhes) te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “O I dërguari i

Zotit, All-llahu xh.sh. nuk turpërohet nga e vërteta. A duhet të pastrohet gruaja nëse në ëndërr përjeton orgazëm?” I tha: **“Po, nëse sheh lagështi.”** Ummi Selemeja tha: “Janë çmendur gratë, e mjera ti a, thua edhe gruaja përjeton orgazëm në ëndërr”? Pejgamberi a.s. iu përgjigj: **“Po si, me çka do t’i përngjajë fëmija asaj?”** Pejgamberi a.s. me këtë kishte për qëllim se foshnja krijohet prej spermës së burrit dhe vezores së gruas, dhe për këtë ajo i përngjan nënës.

All-llahu xh.sh. në Kur’an thotë:

“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun nga një farë e përzier (Emshaxhin) për ta provuar dhe e bëmë që të dëgjojë dhe të shohë” (Dehr-2).

Ibni Kethiri thotë: “Fjala Emshaxh don të thotë përzierje. Pra, fjala është për përzierjen e spermës së burrit dhe vezores së gruas kur bashkohen.”

Përgjigjet për këso pyetje komplekse dhe të ndjeshme, i morën përsipër gratë e tij të pastra. Andaj edhe Aisheja r.a. thotë: “All-llahu i mëshiroftë gratë e ensarëve, ngaqë nuk u pengonte turpi që të pasurohen me dituri fetare.” Kishte prej tyre që në errësirë vinin te Aisheja për ta pyetur për disa rregulla fetare dhe për çështje të hajzit, nifasit, papastërtisë etj. Kështu gratë e Pejgamberit a.s. ishin mësueset dhe udhëzueset më të dobishme. Nëpërmjet tyre gratë fituan dituri në fenë e All-llahut.

E dimë se Sunneti nuk është vetëm fjala e Muhammedit a.s., por ai i përmbledhë fjalët, punët dhe pëlqimet e tij, e të gjitha këto janë parime që duhet t’i pasojë ky ummet. E kush do të na i përcillte lajmet dhe punët e tij në shtëpi më mirë se nënat e besimtarëve, të cilat

All-llahu xh.sh. i nderoi që të jenë gratë e Pejgamberit fisnik në këtë botë dhe në botën tjetër. Pa dyshim se gratë e Pejgamberit a.s., meritojnë çdo respekt dhe lëvdatë për ndriçimin e shumë punëve dhe veprave shtëpiake të Pejgamberit a.s.. Disa prej grave të Pejgamberit a.s. u bënë edhe mësueset me të shquara dhe transmetuese të njohura të haditheve, të cilat dalloheshin me mbamendje, përpikëri dhe mendjemprehtësi.

2. QËLLIMI LEGJISLATIV

Tani do të flasim për qëllimin legjislativ, që është pjesë e qëllimeve të martesës së Pejgamberit a.s. me shumë gra. Ky qëllim shumë thjesht mund të kuptohet, ngaqë erdhi për largimin e disa traditave paraislame dhe të papëlqyera si p.sh., çështja e bijësimit të cilën arabët e aplikonin para Islamit. Një veprim i tillë kishte marrë formën e zakonit fetar që trashëgohej brez pas brezi. E merrte ndokush një fëmijë që nuk ishte nga loza e tij dhe e konsideronte si të ishte nga loza e tij. E konsideronte djalë të vetin sikur djalin nga gjaku në çdo pikëpamje, në trashëgimi, kurorëzim, martesë, në martesë të ndaluara miqësisht, e shumë zakone të tjera që ishin bërë zakon fetar në xhahilijet.

Kur ndokush e bijësonte fëmijën e tjetrit, i thoshte: “Ti je biri im, të trashëgoj dhe të më trashëgosh.”

Islami nuk i pëlqeu gjërat që ishin në kundërshtim me natyrën njerëzore dhe nuk i la njerëzit të hutuar në errësirën e injorancës. Pejgamberi a.s. para Shpalljes e bijësoi Zejd bin Harithin, ashtu siç vepronin arabët. Ky veprim i Muhammedit a.s. ka ndodhë para Shpalljes. Sa i përket shkakut të bijësimit, ekzistojnë urtësi dhe arsye

shumë interesante, i kanë cekur biografët dhe komentuesit e Kur'anit, por për shkak të hapësirës nuk mund të zgjerohemi e t'i cekim. Kështu pra, Muhammedi a.s. e bijësoi Zejd bin Harithin dhe njerëzit filluan ta thirrnin "Zejd bin Muhammed." Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi prej Abdullah bin Omerit se ai ka thënë: "Më të vërtetë Zejdin, të birin e Harithit, nuk e thirrnim ndryshe veçse Zejd bin Muhammed derisa zbriti ajeti kur'anor: *"Ju thirrni ata sipas etërve të tyre. Kjo është më e drejtë te All-llahu."* Atëhere Muhammedi a.s. i tha: **"Ti je Zejdi, i biri i Harithit."**

Pejgamberi a.s. Zejdin e martoi me vajzën e hallës së vet (Zejneben, të bijën e Xhahshul Esedijes). Një kohë jetuan së bashku, por kjo bashkëshortësi nuk zgjati shumë për shkak të marrëdhënieve jo të mira. Ajo shpesh e ngrente zërin sepse e shihte veten në pozitë më të lartë se ai. Zejdi ishte rob para se ta merrte Pejgamberi a.s., e ajo me prejardhje fisnike dhe autoritative.

Urtësi e All-llahut xh.sh. ishte që Zejdi ta shkurojë Zejneben dhe e urdhëroi Muhammedin a.s. që ta martojë atë, për ta asgjësuar çështjen e bijësimit, t'i vendosë bazat e shëndosha të Islamit dhe ta çrrënjosë xhahilijetin. Pejgamberi a.s. frikohej se hipokritët dhe të këqijtë do të flasin dhe do të thonë: "Muhammedi e martoi gruan e birit të vet", andaj edhe e zvarriti një kohë derisa erdhi urdhri i All-llahut xh.sh. në formë qortuese:

"Dhe ti u druani njerëzve (nga thashethemet), por e drejtë është t'i druash Zotit (vetëm Atij). Meqë Zejdi plotësoi dëshirën e vet (martesën dhe ndarjen), Ne atë ta kurorëzuar ty, në mënyrë që

besimtarët të mos ngurrojnë të martohen me gratë e djemve të bijësuar të tyre, pasi që ata e plotësuan dëshirën ndaj tyre, e urdhri i Zotit xh.sh. është i pambaruëshëm” (Ahzab-37).

Kështu pra mori fund bijësimi dhe u flakën shumë zakone që i ndiqnin në xhahilijet e që ishin vetëm adete fetare të tyre pa kurrfarë baze. Zbriti fjala e All-llahut xh.sh. që edhe më tepër e vërtetoi këtë rregull të ri hyjnor:

“Muhammedi nuk është baba i askujt prej njerëzve (burrave) tuaj, por është Pejgamber i Zotit dhe vula e pejgamberëve” (Ahzab-40)

Kjo martesë u bë me urdhrin e All-llahut xh.sh. e nuk u bë pse e shtynin epshi dhe dëshira siç mendojnë disa shpifës të marrë dhe armiq të All-llahut, por u bë për shkaqe të arsyeshme dhe qëllime të ndershme, e ato janë eliminimi i zakoneve paraislame. Qëllimin e kësaj martesë e qartësoi All-llahu xh.sh. me fjalën e Tij kur thotë: *“...në mënyrë që besimtarët të mos ngurrojnë që të martohen me gratë e djemve të bijësuar të tyre, pasi që ata e plotësuan dëshirën ndaj tyre.”*

Transmeton Buhariu se Zejnebja r.a. shpeshherë krenohej para grave tjera të Pejgamberit a.s. duke thënë: “Juve ju martuan prindërit (familjet) tuaja, ndërsa mua më martoi All-llahu xh.sh. përmbi shtatë katë qiej.”

Ja, kështu kjo martesë u bë për shkaqe legislative dhe me urdhrin e të Urtit e të Gjithëdijsmit. I lartësuar qoftë Ai nga ata që përzihen në qëllimet e Tij dhe e vërtetë është fjala e All-llahut xh.sh. kur thotë:

..E juve u është dhënë vetëm pak dijëni.” (Isra-85)

3. QËLLIMI SOCIAL

Qëllimi i tretë është qëllimi social. Ky qëllim vërehet qartë në martesën e Pejgamberit a.s. me bijën e Ebu Bekrit, këshilltarit të parë dhe me bijën e Omerit, këshilltarit të dytë, Zoti qoftë i kënaqur me këta të dy. Gjithashtu edhe lidhja e Pejgamberit a.s. me kurejshitet fisërisht dhe miqësisht përmes martesës me disa nga bijat e tyre u bë një lidhje shumë e fortë. Kjo miqësi bëri që shumë zemra të bashkohen rreth tij dhe thirrjes së tij në Islam, me plot bindje dhe krenari.

Muhammedi a.s. e martoi Aishen, bijën e njeriut më të dashur dhe i cili ishte shumë i afërt me Të dërguarin. Ishte ky Ebu Bekër Siddiki r.a. i cili i pari e përqafoi Islamin dhe i cili me shpirt, trup dhe pasuri luftoi në rrugën e ngritjes së Fesë islame dhe mbrojtjen e Pejgamberit a.s. Ai gjithashtu përjetoi shumë mundime në rrugën e Islamit saqë Muhammedi a.s. në një hadith që e transmeton Tirmidhiu tregon vlerën njerëzore të Ebu Bekrit dhe thotë: *“Çdokush që shtriu dorën (e ndihmës) ne ia kompensuam atë përveç Ebu Bekrit. Ai shtriu dorën e ndihmës e atë do t’ia kompensojë All-llahu xh.sh. Ditën e Kijametit. Nuk kam pasur dobi prej asnjë pasurie si prej asaj të Ebu Bekrit. Nuk ia kam paraqitur Islamin askujt e të mos ketë pasur rezervë përveç Ebu Bekrit, i cili pa u hamendur e pranoi atë. Po ta kisha marrë si të dashur ndokënd, do ta merrja Ebu Bekrin si të dashur. Dijëni se ky shok i juaj është i dashur i Zotit xh.sh.”* (Tirmidhiu).

Dhurata më e madhe që ia dha Pejgamberi a.s. Ebu Bekrit në këtë botë dhe që e qetësoi shpirtërisht ishte martesë me të bijën e tij, kështu që u lidhë ndërmjet tyre miqësi dhe afrim që edhe më tepër ua forcoi dashurinë dhe lidhjen që kishin mes veti.

Gjithashtu Pejgamberi a.s. e martoi Hafsen, të bijën e Omerit, dhe kjo martesë ishte qetësi shpirtërore për babain e saj për shkak të Islamit të tij, drejtësisë, sinqeritetit dhe sakrificimit të tij për këtë fe. Omeri ishte hero i Islamit me të cilin All-llahu xh.sh. i forcoi edhe më tepër Islamin dhe muslimanët, e me atë u ngrit lartë flamuri i fesë islame. Lidhja e tij miqësore me Omerin ishte dhuratë më e madhe për të dhe për veprimtarinë e tij në fushën islame. Me anë të kësaj miqësie ai e barazoi Omerin me këshilltarin e tij të parë, Ebu Bekrin. Kjo pra ishte dhurata më madhështore në këtë jetë me të cilën i nderoi Resulull-llahu për besnikërinë dhe heroizmin e tyre. Sa mirënjohje e mirë dhe sa shpërblim i madh për të sinqertit.

Gjithashtu Pejgamberi a.s. u bëri nder Uthmanit (Osmanit) dhe Aliut kur i martoi me bijat e veta. Këta katër janë shokët më të ngushtë të tij dhe halifët pas tij në përhapjen e fesë dhe thirrjes islame. Sa urtësi e mirë dhe sa qëllim fisnik.

4. QËLLIMI POLITIK

Shkaku i këtyre martesave ishte që Pejgamberi a.s. t'ua zbusë zemrat disa kundërshtarëve të tij dhe të bëjë afrimin e disa fiseve rreth veti. Natyrisht, kur dikush e marton një vajzë të një fisi apo familjeje, atëherë mes tyre lidhet miqësia dhe ata duhet ta ndihmojnë dhe ta

mbrojnë atë. Do të japim disa shembuj që do ta bëjnë të qartë shkakun e martesave të Pejgamberit a.s. me disa nga ato.

1. Pejgamberi a.s. e martoi Xhujejriën, të bijën e Harithit, kryetar i fisit Beni Mustalak. Ajo bashkë me popullin e saj u zu rob. Meqë u robërua ajo dëshironte ta paguajë veten. Erdhi te Pejgamberi a.s. dhe kërkoi t'i ndihmojë me pasuri. Pejgamberi a.s. kërkoi që t'ia paguajë çmimin e liritimit e ta martojë atë me ç'rast ajo pranoi një gjë të tillë. Muslimanët thanë: "A miqtë e Resulull-llahut i kemi robëruar"? I liruan të gjithë të robëruarit dhe kur e panë pjesëtarët e fisit Beni Mustalak këtë mirësi dhe humanitet, të gjithë e pranuan Islamin dhe u bënë prej besimtarëve të mirë. Martesa e Pejgamberit me Xhujejriën ishte begati e madhe sepse ajo ishte shkaktare që fisi i saj e pranoi Islamin dhe u lirua, e sidomos bujaria e saj në mesin e popullit të vet ishte faktori më bindës. E gjithë kjo ngjarje është e përshkruar në Sahihun e Buhariut të përcjellur nga Aishja r.a., ku thotë: "Pejgamberi a.s. e bëri ndarjen e grave të Beni Mustalakut (pasi që e ndau të pestën) në mesin e luftëtarëve. Kalorësve u takonin dy gra kurse këmbësorëve nga një. Kështu Xhujejria, e bija e Harithit, i bie fat Thabit bin Kisit. Atëherë ajo vjen te Pejgamberi a.s. dhe i thotë: "O Resulull-llah, unë jam Xhujejria, e bija e Harithit, kryetar i këtij populli dhe ti e di se ç'po ndodh me mua. Thabiti më ka caktuar çmimin prej nëntë evakësh. Më ndihmo të lirohem." Pejgamberi a.s. ia ktheu: "**A don edhe më mirë?**" Ajo i tha: "Si?." Ai i tha: "**Do ta paguaj çmimin e përcaktuar e pastaj të të martoj.**" Ajo ia ktheu: "Me plot dëshirë o Resulull-llah." Atëherë Pejgamberi a.s. i

thotë: **“Kështu u vendos.”** Lajmi u përhap në popull dhe thanë: “A thua miqtë e Resulull-llahut të robërohen?!” Kështu muslimanët i liruan të gjithë robërit, saqë numri i tyre arriti në njëqind familje për shkak të martesës së Pejgamberit a.s. me bijën e kryetarit.

2. Gjithashtu Muhammedi a.s. e martoi Safijen, të bijën e Hujej bin Ahtabit. Ajo u robërua pas vrasjes së burrit të saj në Luftën e Hajberit dhe u ra hise disa muslimanëve. Pas një konsultimi, ata thanë: “Kjo grua është e parisë së fisit Beni Kurejdha dhe këtë çështje duhet t’ia paraqesim Resulull-llahut.” Pejgamberi a.s. e thirri atë dhe ia paraqiti dy zgjidhje:

a) Ta lirojë dhe ta martojë atë për vete dhe

b) Ta lirojë dhe të kthehet te familja.

Ajo kur pa sjelljen dhe shëmbëlltyrën e Muhammedit a.s., e pranoi lirim dhe martesën me të. Me kalimin e saj në Islam, shumë njerëz nga populli i saj e pranuan këtë fe. Transmetohet se kur hyri ajo te Pejgamberi a.s., ai i tha: **“Babai yt prej çifutëve ishte armiku im më i përbetuar derisa e mori All-llahu.”** Ajo i tha: “O I dërguari i Zotit, All-llahu xh.sh. në Kur’an thotë:

*“Dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit” -
(En’am-164).*

Pejgamberi a.s. i tha: **“Zgjedh. Nëse e zgjedh Islamin të mbaj për vete, e nëse e zgjedh hebraizmin, ndoshta të liroj të shkosh te familja yte.”** Ajo i tha: “Përqafova Islamin dhe të besova ty para se të më pranosh të jem nën mbrojtjen tënde. Në fenë hebraike nuk kam mbrojtje, nuk kam babë e as vëlla. Më propozove të zgjedh Islamin apo kufrin. All-llahu xh.sh. dhe I dër-

guari i Tij janë më të dashur për mua se lirimi nga robëria dhe kthimi te familja.”

3. Gjithashtu Pejgamberi a.s. e martoi Ummi Habiben (Remle bint Ebu Sufjan). Në atë kohë Ebu Sufjani ishte bartës i flamurit të shirkut dhe armiku më i përbetuar i Muhammedit a.s. Vajza e tij e pranoi Islamin qysh në Mekke. Më vonë ajo bashkë me burrin e saj bëri hixhret në Abisini për ta ruajtur fenë e vet. Atje asaj i vdiq burri dhe mbeti e vetme, pa shoqërues dhe ndihmës. Kur mori vesh Pejgamberi a.s. për këtë, kërkoi nga mbreti i Abisinisë, Nexhashiu, që ta marrë për grua. Kur e lajmëroi Nexhashiu, ajo u gëzua pa masë sa që gëzimin e saj nuk mund ta vlerësonte askush tjetër pos All-llahut xh.sh. U gëzua sepse nëse kthehej te familja e vet, ata do ta detyronin ta braktisë Islamin e të kthehet në kufër, apo do ta dënonin rreptë. Për të Pejgamberi a.s. dha katërqind dinarë sadakë (mehër) duke ia bashkangjitur edhe disa dhurata tjera. Kur u kthye ajo në Medine Munevvere e martoi Pejgamberi a.s. Kur i shkoi lajmi Ebu Sufjanit, ai sikur e pëlqeu një gjë të tillë dhe tha: “S’është punë të mashtrohet ky djalë.” Bile ai u krenua me Pejgamberin a.s. dhe nuk mohoi një gjë të tillë, derisa All-llahu xh.sh. e udhëzoi në Islam. Këtu pra shihet rëndësia e qëllimit të martesës së Pejgamberit a.s. me bijën e Ebu Sufjanit. Sidomos kjo martesë ndikoi shumë në zbutjen e mundimeve ndaj muslimanëve, posaçërishtë kur mes këtyre të dyve u lidhën miqësia dhe afërsia. Edhe pse Ebu Sufjani atëbotë ishte armiku më i përbetuar i Pejgamberit a.s. dhe i muslimanëve nga familja e Beni Umejëve, martesë me bijën e tij e zbuti zemrën e tij, fisit dhe të të afërmve të tij. Sidomos martesë e saj me Resulull-lla-

hun ishte nderim i madh ndaj Ummi Habibes për imanin e saj kur ajo braktisi shtëpinë për hir të Fesë islame. A thua mund të ketë veprime më të drejta dhe urtësi më e madhe?!!

GRATË E PEJGAMBERIT

Meqë folëm për shkakun e martesës së Pejgamberit a.s. me më shumë gra, do të flasim pak edhe për nënat e pastra të besimtarëve, Zoti qoftë i kënaqur me to. All-llahu xh.sh. i zgjodhi për të dashurin e Tij, Muhammedin a.s. Ato i nderoi me këtë nder të madh, nderin e bashkimit të tyre me vulën e pejgamberëve, i zgjodhi nga shumë gra të tjera dhe i bëri nëna të besimtarëve duke i obliguar t'i respektojnë e nderojnë. E bëri të ndaluar (haram) martesën me to edhe pas vdekjes së Resulull-llahut, në shenjë respekti për të. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Pejgamberi është më mbikëqyrës për besimtarët se sa ata për vetveten, e gratë e tij janë (si) nënat e tyre” (Ahzab-6)

Gjithashtu thotë:

“Juve nuk u lejohet që ta shqetësoni Pejgamberin e Zotit, e as që t'i martoni gratë e tij kurrë pas tij. Kjo me të vërtetë te All-llahu xh.sh. është mëkat i madh” (Ahzab-53).

Imam Kurtubiu në tefsirin e tij “EL XHAMUL AHKAMIL KUR'AN” citon: “All-llahu xh.sh. i nderoi

gratë e Pejgamberit të Tij sepse i bëri nëna të besimtarëve, sidomos në obligueshmërinë e respektit, mirësjelljes, nderimit dhe ndalesës së martesës me to, madje edhe pas vdekjes së tij alejhis-selam.”

E kjo njëherit është respekt për Pejgamberin a.s. dhe nder për gratë e tij.

* * *

Gratë, të cilat njëherit janë edhe nënat e muslimanëve, të cilat i martoi Pejgamberi a.s. e që numri i tyre arrin në njëmbëdhjetë, janë:

1. HATIXHE BINT HUVEJLID
2. SEVDA BINT ZUMAH
3. AISHE BINT EBU BEKER
4. HAFSA BINT OMER
5. ZEJNEB BINT XHAHSH EL-ESEDIJE
6. ZEJNEB BINT HUZEJME
7. UMMI SELEME (HIND BINT EBU UMEJE)
8. UMMI HABIBE (REMLE BINT EBU SUFJAN)
9. MEJMUNE BINT HARITH EL-HILALIJE
10. XHUVEJRIJJE BINT HARITH
11. SAFIJE BINT HUJEJ BIN AHTAB

1. HATIXHE BINT HUVEJLID

Ajo ishte gruaja e parë e Muhammedit a.s. të cilën e martoi para Shpalljes, kur ai kishte njëzet e pesë vjet e ajo dyzet vjet. Para se ta martojë Pejgamberi, ajo dy herë kishte qenë e martuar. Herën e parë me Ebu Hale bin Zerare e herën tjetër me Atik bin Aidh. Resulullahu e zgjodhi për shkak të shkathtësisë dhe mendjemprehtësisë së saj. Martesa e tij me të ishte një urtësi e qëlluar, sepse ishte martesë e të mençurit me të mençu-

rën. Dallimi në moshë nuk ishte pengesë e kësaj martese sepse nuk kishte për qëllim kënaqjen e epshit, por u bë për qëllime njerëzore dhe të pastra. Muhammedin, All-llahu xh.sh. e zgjodhi që ta bartë këtë mision, t'i përballojë vështirësitë gjatë thirrjes, dhe mu për këtë Ai ia zgjodhi atij këtë grua të devotshme dhe të singertë, të mençur dhe mendjemprehtë që t'i ndihmojë në përhapjen e fesë dhe të këtij misioni. Hatixheja ishte gruaja e parë që e pranoi Islamin.

Ajo që dëshmon mençurinë e saj është: se kur Muhammedit a.s. i erdhi Xhibrili në shpellën Hira, ai u kthye te bashkëshortja e tij me zemër të trishtuar duke i thënë: **“Më mbulo, më mbulo!”** Kur i kaloi frika i rrefeu Hatixhes se ç'kishte ndodhur me të dhe i tha: **“Me të vërtetë u frikova për veten time.”** Ajo i tha: “Përgëzohu, se pasha Zotin, Ai ty nuk të dëshpëron asnjëherë. Ti i viziton të afërmit, e flet të drejtën, u bën ballë vështirësive, i jep nevojtarit, e nderon musafirin dhe e ndihmon të drejtën. “Ky hadith është transmetuar në Sahihun e Buhariut dhe Muslimit.

Pejgamberi a.s. me Hatixhen e kaloi rininë e vet më të lumtur, nuk kishte grua tjetër krahas saj dhe nuk dashuronte asnjë tjetër siç e donte Hatixhen. Aisheja ia kishte xhelozinë asaj edhe pse nuk ishin të të njëjtës moshë e as s'e kishte parë, derisa njëherë ndodhi që Pejgamberi a.s. e përmendi Hatixhen e Aisheja i tha: “Ajo nuk ka qenë diç tjetër veçse një grua e moshuar dhe plakë. All-llahu të ka zëvendësuar edhe më të mira, se ajo (kishte për qëllim vetveten).” Pejgamberi a.s. kur i dëgjoji këto fjalë u hidhërua dhe i tha asaj: **“Jo pasha Zotin, All-llahu nuk më ka dhënë më të mirë se ajo. Më besoi kur më mohonin të gjithë, m'i vërtetoi**

fjalët kur të tjerët më përgënjeshtonin, m'u gjend pasuria e saj kur nuk më jepnin të tjerët dhe më dhuroi Zoti xh.sh. me të fëmijë e jo edhe me të tjerat.” Aisheja r.a. tha: “Pas këtij rasti kurrë më nuk e kam përmendur atë për të keq.” Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi se ajo ka thënë: “Nuk ia kisha xhelozinë asnjërës prej grave siç ia kisha Hatixhes, edhe pse asnjëherë nuk e kisha parë. Mirëpo Pejgamberi a.s. shumë e kujtonte, bile edhe therte nga një dele dhe ua çonte të afërmve të Hatixhes, dhe thoshte: **“Ajo ishte kështu e kështu dhe me të pata fëmijë.”**”

Hatixheja me Pejgamberin a.s. jetoi njëzet e pesë vjet, pesëmbëdhjetë para Shpalljes dhe dhjetë pas saj. Pejamberi nuk u martua me ndonjë grua tjetër derisa e kishte Hatixhen. Të gjithë fëmijët i kishte me të përveç Ibrahimit. Kur ajo u shpërngul në mëshirë të All-llahut xh.sh., Pejgamberi veç i kishte mbushur të pesëdhjetat e nuk kishte grua tjetër dhe nuk martoi tjera gra deri pas vdekjes së saj. All-llahu xh.sh. qoftë i kënaqur me të dhe xhennetin e bëftë vendbanim të saj.

2. SEVDA BINT ZUM'AH

Pejgamberi a.s. Sevdanë e martoi pas vdekjes së Hatixhes. Ajo ishte e veja e Sekran bin Amer el-Ensariut dhe ishte ndër besimtares e para që bëri hixhret. Asaj i vdiq burri pas kthimit prej hixhretit të dytë në Abisini, kështu që mbeti e vetmuar pa mbrojtës dhe kujdestar. Mu për këtë shkak e martoi Resulull-llahu edhe pse ishte më e moshuar se ai. Po të kthehej te familja pas vdekjes së burrit, ndoshta do ta detyronin ta braktisë fenë dhe të kthehet në shirk, ose do ta mundonin shumë. Pra, Pejgamberi a.s. e zgjodhi atë që të kuj-

deset dhe e martoi. Ky ishte kulmi i bamirësisë dhe nderit për të, sidomos për besimin dhe sinqeritetin që kishte ndaj All-llahut dhe Të dërguarit të Tij.

Po të nxitej nga epshi, siç mendojnë orientalistët iftiraxhinj, ai do të largohej prej saj sepse ajo ishte e vejë dhe e moshuar, kishte mbushur pesëdhjetë e pesë vjet, por Pejgamberi a.s. ka qenë shembulli më i lartë në devotshmëri, njerëzi dhe burrëri dhe nuk kishte qëllim tjetër, por vetëm ta mbrojë dhe të kujdeset për të.

3. AISHE BINT EBU BEKËR

E vetmja beqareshë që e martoi Muhammedi a.s. ishte Aisheja, e bija e Ebu Bekrit. Ajo ishte njëra ndër më të zgjuarat dhe më të mençurat, bile edhe ishte më e ditur se shumë burra. Shumica prej as'habëve më të ditur dhe më të mëdhenj e pyetnin për disa çështje dispozitare, të cilat u ishin të paqarta të cilat ajo ua sqaronte.

Transmetohet prej Musa el-Esh'ariut se ai ka thënë: “Nuk ka pasë hadith që ne as'habët e Pejgamberit nuk e kuptonim, e që kur e pyetnim Aishenë të mos gjenim te ajo dituri (sqarim) për të.” Transmeton Ebu Duha prej Mesrukut se ai ka thënë: “I kam parë edhe as'habët më të mëdhenj të Pejgamberit a.s. kur e pyetnin Aishenë për çështje të trashëgimisë.” Urve bin Zubejri thotë: “Nuk kam parë grua më të ditur në lëmin e mjekësisë, fikhut dhe poezisë se Aisheja.”

Nuk është çudi se edhe librat e hadithit dëshmojnë për diturinë dhe mendjemprehtësinë e saj. Nuk ka transmetuar kush hadithe sahih më shumë se ajo përveç dy burrave: Ebu Hurejreja dhe Abdullah bin Omeri. Aishenë Pejgamberi a.s. e donte më shumë se gratë

tjera, mirëpo në ndarje ishte i drejtë dhe thoshte: “O Zot, unë e ndaj njëjtë atë që e posedoj, mos më rëndo në atë që nuk e posedoj.”

Kur zbriti ajeti i zgjedhjes, Pejgamberi a.s. filloi prej Aishesë dhe i tha: **“Do të kërkoj prej teje diçka por njëherit konsultoi prindërit tu”**, e ai bukur mirë e dinte se ata nuk e urdhëronin që të ndahej prej tij. Ia lexoi asaj fjalën e All-llahut xh.sh:

“O ti Pejgamber, thuaju grave tua: “Në qoftë se lakmoni jetën e kësaj bote dhe stolitë e saj atëherë ejani, unë po ju jap furnizim (për lëshim) dhe po ju lëshoj ashtu si është e udhës. E në qoftë se e doni All-llahun, Të dërguarin e Tij dhe botën tjetër, atëherë të jeni të sigurta se All-llahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë punë të mira.” (Ahzab-28-29)

Aisheja r.a. i tha: “A edhe për këtë kërkon t’i konsultoj prindërit. Unë e dua All-llahun, Të dërguarin e Tij dhe Ditën e Gjykimit.”

Miqësia e Pejgamberit a.s. për Ebu Bekrin ishte dhurata më e madhe në këtë botë. Gjithashtu ishte një mënyrë e mirë për përhapjen e Sunnetit të tij të pastër, meritave bashkëshortore të tij dhe dispozitave të shariatit të tij, sidomos për çështjet që u përkasin grave sikur që përmendëm kur bëmë fjalë për qëllimin arsimor.

4. HAFSA BINT OMER

Edhe Hafsa ishte e vejë. Burri i saj ishte Hunejs ibni Hudhafe i cili ishte prej ensarëve. Ai ra shehid në Luftën e Bedrit pasi iu nënshtrua një provimi të mirë. Ishte nga trimat dhe guximtarët për të cilët është

shkruar në faqet e historisë, për trimëri, burrëri dhe xhihad.

Omeri radijall-llahu anhu, ia paraqiti Uthmanit për martesë pas vdekjes së bashkëshortes së tij Rukijes, bijës së Pejgamberit a.s. por ai nuk pranoi. Më vonë e martoi Pejgamberi a.s. dhe kjo ishte bamirësi, nder dhe respekt për babain e saj, Omerin r.a.

Transmeton Buhariu nga Abdullah bin Omeri: “Kur Hafsa mbeti e vejë prej Hunejs ibni Hudhafes, Omeri e takoi Uthmanin dhe i tha: “Si të duash, ta martoj Hafsen.” Uthmani i tha: “Do të mendoj pak.” Kaluan disa ditë dhe i tha: “Më thotë diçka që mos të martohem.” Tha Omeri: “I thashë edhe Ebu Bekrit: Si të duash, ta martoj Hafsën. Ai heshti.” Pas disa ditësh e kërkoi Pejgamberi a.s. dhe e martova me të. Më vonë më takoi Ebu Bekri dhe më tha: “A të kujtohet se kur ma paraqite Hafsën për martesë nuk ta ktheva përgjigjen?” I thashë: “Po.” Tha: “Asgjë nuk më pengonte që ta kthej përgjigjen ty, por e mora vesh se Pejgamberi a.s. e kishte përmendur atë dhe nuk desha ta zbuloj sekretin e tij. Po të mos e martonte ai, unë do ta pranoja.”

Ky pra është një nder i vërtetë dhe burrëri e drejtë që u pa nga gjesti i Omerit. Ai donte që nderi i tij të jetë i sigurt. Nuk ndjente në vete kurrfarë turpi që t’ia ofrojë bijën e vet një mbrojtësi të mirë, sepse martesë është bazë e një shoqërie të lumtur. Ku jemi ne muslimanët sot që nuk i njohim mirë dispozitat islame, bukurinë dhe shkëlqimin e tij. I lëmë vajzat të pamartuara derisa të vijë e ta kërkojë dikush që ka pasuri të madhe?!

5. ZEJNEB BINT HUZEJME

Pejgamberi a.s. e martoi Zejneben pas Hafsës. Ajo ishte e veja e shehidit të parë në Islam, Ubejdes, të birit të Harithit, të birit të Abdulmuttalibit, i cili ra dëshmor në fillim të Betejës së Bedrit. Në momentin kur burri i saj ra shehid, ajo kryente obligimin e vet në dhënien e ndihmës të plagosurve dhe ua lidhte plagët. As vrasja e bashkëshortit nuk i pengoi asaj në kryerjen e obligimit të vet, derisa erdhi fitorja e muslimanëve në fillim të betejës me mushrikët. Kur dëgjoi Resulull-llahu për durimin dhe qëndrueshmërinë e saj në luftë dhe se nuk kishte kush të kujdeset për të dhe ta mbrojë, e kërkoi atë për vete, e strehoi dhe u përkujdes pasi që iu nda ai që i ndimonte dhe kujdesej për të.

Dijetari i famshëm Muhamed Savvaf, në artikullin e tij me vlerë *“Gratë e pastra të Pejgamberit”*, pasi që e përmend ngjarjen e rënies së burrit të saj dëshmor duke treguar bujari e shëmbëlltyrë thotë: “Kur e martoi Pejgamberi a.s. ajo i kishte kaluar të gjashtëdhjetat. Nuk jetoi me Muhammedin a.s. më tepër se dy vjet. Çdo të thonë të marrët për këtë martesë të ndershme dhe qëllimin e saj të pastër. A edhe këtu ka vend për të thënë diçka iftiraxhinjtë e poshtër? A mund të kenë këtu vend epshi dhe dëshira? Apo mos vallë edhe këtu nuk e gjejnë bujarinë, butësinë, krenarinë, mëshirën, vlerën dhe bamirësinë e Pejgamberit më të madh të njerëzimit i cili erdhi si mëshirë për botët. Le t’i frikohen Zotit orientalistët urrejtës dhe le ta shpiejnë në vend amanetin e diturisë, le të mos e tradhtojnë atë, sidomos për qëllime të këqija që i orientuan dhe i mësuan shkencat Islame për ta poshtëruar, mashtruar dhe për t’ia ulë autoritetin Muhammedit a.s.

6. ZEJNEBE BINT XHAHSHI

Pejgamberi a.s. e martoi atë, edhe pse ishte e vejë. Atë e kishte martuar Zejd bin Harithi, e pas ndarjes nga ai e kishte martuar Resulull-llahu. Edhe kjo martesë nuk dallon nga martesat me gratë tjera. Secila martesë kishte qëllimin e vet, por edhe martesat me Zejneben kishte qëllimin e vet të rëndësishëm, e ai ishte eliminimi i çështjes së bijësimit për të cilën gjë bëme fjalë në qëllimin legjislativ. Rasti më i volitshëm që gjetën qëllimkëqijtë urrejtës dhe orientalistët mashtrues ishte martesat e tij me Zejneben, për t'i shpifur trillimet e veta për Pejgamberin e pastër. Ata kishin mbështetje në disa israeliate të pavërteta e që janë përmendur në disa libra të tefsireve. “Shpifën dhe sa keq shpifën, se gjoja Pejgamberi a.s. ka kaluar nga shtëpia e Zejdit kur ai nuk ishte në shtëpi. E pa Zejneben, e dashuroi dhe i hyri në zemër, dhe i tha: “I lartësuar je Ti që i ndryshon (i ke në dorë) zemrat.” I dëgjoji Zejnebja fjalët e tij dhe kur erdhi burri i saj e lajmëroi se çka kishte dëgjuar prej Pejgamberit a.s. Edhe ai e kuptoi se Pejgamberit a.s. i kishte hyrë në zemër ajo. Shkoi te Pejgamberi a.s. për ta shkurorëzuar atë kurse Pejgamberi i tha atij: “Mbaje familjen tënde (gruan tënde)” kurse në zemër e dëshironte kinse të kundërtën, dhe kështu e shkurorëzoi Zejdi që ta martojë Pejgamberi.”

Si reagim ndaj pohimeve të tyre të gabuara, Ibni Arabiu në tefsirin e tij “*Ahkamul Kur'an*” thotë: “Shpifjet e tyre se gjoja Pejgamberi a.s. e paska parë Zejneben dhe i paska hyrë në zemër janë të pavërteta, sepse ai me të ka qenë tërë kohën dhe në çdo vend, bile atëherë ende nuk kishte hixhab. Si mundej që të rritej me të, ta vërente në çdo moment e mos ta kishte dashu-

ruar më herët, por një gjë të tillë ta bëjë pasi ajo të ketë burrë. Ajo edhe ia ofroi vetveten që ta martojë më parë, e si mundet që më vonë të ketë një dëshirë që nuk ka ekzistuar. S'është e mundur që kjo zemër e pastër të ketë kësaj synime të këqija. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete në të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre për t'i sprovuar në të.” (Taha-131).

I thekson bukur mirë ky dijetar këto israilijate dhe thotë se të gjitha këto janë transmetime të pavërteta dhe të shpifura.

Vëllezër të dashur!

Një shikim i thjeshtë i historisë së Zejnebes dhe rrethanat e martesës me Zejdin, na bëjnë të bindemi se marrëdhëniet jo të mira që lindën mes tyre ishin për shkak të dallimeve të tyre në aspektin shoqëror. Zejnebja ishte femër me autoritet kurse Zejdi deri dje ishte rob. All-llahu e sprovoi atë me martesën me Zejdin për ta mënjanuar fanatizmin familjar dhe autoritetin xhahilit. Islami bëri që autoriteti të jetë në fe dhe devotshmëri. Kur ia ofroi Pejgamberi a.s. Zejnebes martesën me Zejdin ajo refuzoi, sepse ajo kështu do ta ulte poshtë prejardhjen dhe pozitën e saj, derisa zbriti fjala e All-llahut xh.sh.:

“Dhe nuk është për besimtarin dhe besimtaren, kur All-llahu dhe Pejgamberi i Tij caktojnë një gjë ata të bëjnë zgjedhje në atë gjë. Kush e kundërshton All-llahu xh.sh. dhe Pejgamberin e Tij, ai me siguri ka dështuar” (Ahzab-36).

Zejnebja iu nënshtrua urdhrit të Pejgamberit a.s dhe ia dorëzoi trupin Zejdit por jo edhe shpirtin, e që prapa kësaj qëndronte dhembja dhe ngushtësia. Muhammedi a.s. e njihte Zejneben qysh nga voglia, sepse ajo ishte vajza e hallës së tij. Kush do të mund ta ndalte Muhammedin a.s. e mos ta martoj atë? Si mundet që dikuj t'i jepet rasti që ta martojë një beqareshë e nuk e bën një gjë të tillë, e pasi ajo të martohet e të bëhet e vejë, ai ta dashurojë?!!!

Me të vërtetë këta janë një popull që nuk logjikojnë dhe thonë diçka që për të nuk dinë. Trillojnë për Resulull-llahun gënjeshtër, shpifje dhe të pavërteta. Shiko bile edhe çka thonë: “Ajo që e fshehu Muhammedi a.s. ishte dashuria e tij ndaj Zejnebes dhe mu për këtë ai ishte i qortuar.” A është e logjikshme kjo shpifje? A mundet që njeriu të qortohet për shkak se nuk mund ta shpallë haptas dashurinë ndaj gruas së fqit të vet? *“I lartësuar je (O Zot) dhe me të vërtetë kjo është një shpifje e madhe.”*

Ajeti kur'anor shumë qartë e tregon këtë çështje dhe e përmendë se All-llahu xh.sh. do ta zbulojë atë që e fshehu Pejgamberi a.s. *“E ti e mbaje në vetvete atë që All-llahu xh.sh. do ta zbulojë...”*

Çka zbuloi All-llahu xh.sh.?

A mos e zbuloi dashurinë e tij ndaj Zejnebes? Jo, assesi. Por ajo që e zbuloi All-llahu xh.sh. ishte dëshira e Resulull-llahut në zbatimin e urdhrit të All-llahut për ta martuar atë, jo për diç tjetër por për zhdukjen e çështjes së bijësimit (djemve të adoptuar). Por, ai frikëhej nga fjalët e munafikëve se do të thonë: Muhammedi e martoi gruan e birit të vet. Pikërisht për këtë All-llahu xh.sh. e qartësoi atë që e kishte fshehur Muhammedi

a.s. *“Meqë Zejdi e kishte vendosur atë që e kishte menduar ndaj saj, Ne ta kurorëzuam ty atë, e për të mos pasur besimtarët vështirësi (mekat) në martesë me gratë e të bijësuarve të tyre.”*

Ja, kështu pra zhvlerësohen pohimet e iftiraxhinjve para argumenteve të qarta dhe bindëse që dëshmojnë për pejgamberinë e Muhammedit a.s., dëlirësinë dhe pastërtinë e tij nga ajo që ia përshkruajnë të prishurit qëllimkëqij.

7. UMMI SELEME HIND EL MAHZUMIJJE

Kjo ishte e veja e Abdullah bin Abdul Esedit. Burri i saj ishte ndër të parët që pranoi Islamin. Bëri hixhret bashkë me bashkëshorten e vet për ta ruajtur fenë e tyre. Atyre Selemeja u lindi në Abisini. Burri i saj ra shehid në Luftën e Uhudit. Ajo mbeti me katër jetima pa kujdestar dhe mbrojtës. Pejgamberi a.s. nuk pa rrugëdalje tjetër për te dhe për fëmijët e saj pos ta martojë atë. Kur i ofroi fejesë, ajo pak u shqetësua dhe i tha Resulull-llahut: *“Unë jam shumë e moshuar, jam nënë e katër jetimave dhe unë jam shumë xheloze.”* Pejgamberi a.s. iu përgjigj: **“Sa u përket jetimave m’i le mua, dhe e lus All-llahun xh.sh. që ta largojë nga zemra yte xhelozinë”** dhe aspak nuk ia përmendi vjetët. Pas pëlqimit të saj e martoi Pejgamberi a.s. Ai kujdesej për edukimin e fëmijëve të saj, ua hapi zemrën e tij të madhe saqë nuk mendonin fare për humbjen e babait, sepse ata u kompensuan me një baba që ishte edhe më i mëshirshëm se babai i tyre.

Ummi Seleme ishte me prejardhje të mirë e të ndershme, ishte nga një shtëpi fisnike dhe ndër të parat që pranoi Islamin. Por, ajo kishte një vlerë edhe më të

madhe e ajo ishte “Mendimi i Qëlluar.” Neve na mjafton si argument kur Pejgamberi a.s. u këshillua me të për atë që u dëshpërua dhe u brengos për sjelljen e besimtarëve. Ajo që e konsultoi atë ndodhi në “Marrëveshjen e Hudejbisë”, kur besimtarët shumë u prekën me këtë marrëveshje me mushrikët, se duhej lënë luftën anash dhjetë vjet me kushtet e parashtruara. Muslimanët panë se me këtë marrëveshje u shkelën të drejtat e tyre, edhe pse ishin në kulm të fuqisë së tyre. Kjo ndikoi shumë në pakënaqësinë e tyre dhe në zvarritjen e zbatimit të urdhrin të Pejgamberit a.s. kur i urdhëroi t’i qethin kokat e tyre, sepse duhej kthyer në Medine. Askush nuk e zbatoi urdhrin e tij. Ai hyri te bashkëshortja e vet (Ummi Selemeja) dhe i tha: **“U bënë he-laqë këta njerëz. I urdhërova e askush nuk e zbatoi urdhrin tim.”** Ajo e qetësoi duke i thënë që të dalë ai vetë dhe ta qethë kokën e tij para tyre. Iu betua se ata nuk do të hamenden nga zbatimi i urdhrin të tij, se do të binden se ky urdhër është i pathyeshëm dhe se s’ka kthim prej tij. Ashtu edhe ndodhi. Doli Pejgamberi a.s. dhe e urdhëroi një person që t’ia qethë kokën. Kur panë besimtarët, edhe ata shpejtuan e i qethën kokat e tyre duke vepruar si Pejgamberi a.s. E gjithë kjo ndodhi me këshillën e nënës së besimtarëve, Ummi Seleme, Zoti qoftë i kënaqur me të.

8. UMMI HABIBE (REMLE BINT EBU SUFJAN)

Në vitin e shtatë hixhrij, Pejgamberi a.s. e martoi Ummi Habiben. Ajo ishte e veja e Ubejdullah bin Xhahshit i cili vdiq në Abisini. Nexhashiu ia dha atë për grua Pejgamberit a.s. dhe si dhuratë (mehër) i dha katër mijë dirhemë. Ummi Habiben ia dërgoi atij me

Sherhabil bin Husneh. Për shkakun e martesës me të folëm më parë.

9. XHUVJRIJE BINT EL HARITH

Pejgamberi a.s. e martoi Xhuvjrijen, të bijën e Harith bin Dirarit, kryetar i fisit Beni Mustalak. Ajo ishte e veja e Musafi' bin Safvanit i cili u vra ditën e Merisiut ndërsa kjo u robërua nga ana e muslimanëve. Burri i saj ishte ndër armiqtë më të përbetuar të Islamit e sidomos të Resulull-llahut. Për shkakun e martesës me të folëm më parë.

10. SAFIJJE BINT HUJEJ BIN AHTAB

Gjithashtu edhe për shkakun e martesës me të kemi bërë fjalë më parë.

11. MEJMUNE BINT HARITH EL HILALIJE

Emri i saj ishte Berreh por Pejgamberi a.s. e emëroi Mejmune. Kjo ishte gruaja e fundit e Muhammedit a.s. Aisheja r.a. për të thotë: “Ajo më shumë se ne i frikohej All-llahut dhe më shumë se ne i vizitonte të afërmit. Mejmuneja ishte e veja e Ebi Rehm bin Abdul Uzza. Thuhet se Abbasi kishte dashur ta martojë. Ajo që e shtyu të mendojë për martesë ishte mirësia, sjellja e mirë, nderimi i familjes së saj të cilët e përkrahën dhe e ndihmuan Pejgamberin a.s.

* * *

Ky pra ishte një vështrim të shkurtë rreth nënave të besimtarëve dhe bashkëshorteve të pastra të Resulull-llahut, të cilat i nderoi All-llahu xh.sh. që ta shoqërojnë Të dërguarin e Tij dhe i bëri nëna të besimtarëve. U drejtohet atyre dhe u thotë:

“O gratë e Pejgamberit! Ju nuk jeni si gratë tjera. Nëse i druani All-llahut xh.sh. mos flisni përkëdhelshëm e që t’ju dëshirojë ai i cili në zemrën e tij ka sëmundje (qëllim të keq), dhe flisni në mënyrë serioze (të njerëzishme).” (Ahzab-22).

Martesa e Pejgamberit a.s. me to u bë për qëllime të ndryshme, duke u kujdesur për interesin e fese dhe të rregullave të tij. Këto martesa kishin për qëllim zbutjen e zemrave, tërheqjen e disa kryetarëve të fiseve dhe nderimin e disa familjeve.

Të gjitha bashkëshortet e Pejgamberit a.s. ishin të veja përveç Aishesë. Pas hixhretit u martua me shumë gra, e sidomos në vitin kur filluan luftërat ndërmjet muslimanëve dhe mushrikëve. Këto u bënë mes vitit të dytë dhe të tetë hixhrij, kur përfundoi me fitoren e muslimanëve. Për secilën martesë u dhanë argumente bindëse për shëmbëlltyrën, burrërinë, qëllimin e tij njerëzor dhe bamirësinë e tij të pakufishme, e që kundërshtojnë çdo fjalë që e thuan të këqijtë dhe të fëlliqurit. Po të mbizotëronte epshi në zemrën e tij, ai do të martohej në rini dhe do të martonte beqaresha. Por urrejtja e thellë që i ka kapluar zemrat e orientalistëve perëndimorë, ua ka verbuar sytë dhe nuk e shohin të vërtetën e ndritshme. E vërtetë është fjala e All-llahut kur thotë:

“POR, NE ME TË VËRTETËN GJUAJMË NË TË KEQEN E AJO (E VËRTETA) E SHKATËRRON ATË (GËNJESHTRËN) DHE KËSHTU AJO ZHDUKET”

Përmbajtja

HYRJE	5
<i>QËLLIMI I MARTESËS SË MUHAMMEDIT A.S. ME SHUMË GRA.....</i>	<i>12</i>
1. QËLLIMI ARSIMOR.....	12
2. QËLLIMI LEGJISLATIV	15
3. QËLLIMI SOCIAL	18
4. QËLLIMI POLITIK	19
<i>GRATË E PEJGAMBERIT</i>	<i>24</i>
1. HATIXHE BINT HUVEJLID	25
2. SEVDA BINT ZUM' AH	27
3. AISHE BINT EBU BEKËR.....	28
4. HAFSA BINT OMER.....	29
5. ZEJNEB BINT HUZEJME	31
6. ZEJNEBE BINT XHAHSHI	32
7. UMMI SELEME HIND EL MAHZUMIJJE.....	35
8. UMMI HABIBE (REMLE BINT EBU SUFJAN).....	36
9. XHUVEJRIJE BINT EL HARITH.....	37
10. SAFIJE BINT HUJEJ BIN AHTAB	37
11. MEJMUNE BINT HARITH EL HILALIJE.....	37

Muhammed Ali Es-Sabuni
DYSHIMET DHE TË PAVËRTETAT RRETH
SHUMËSISË SË GRAVE TË PEJGAMBERIT A.S.

Redaktor gjuhësor-korrektor
Fatmire Ajdini-Hoxha

Përgatitja kompjuterike
Gazmend Hoxha

Shtypi
Focus - Shkup

Boton
Sh.B. Logos-A
II Mak. brigada, Q.T. "Treska" X/7
91000 Shkup
Tel./Fax: (091) 611-508

Spor ed mi sl eweto na Mini ster st voto za kul tura br . 07-6132/2 od 29.10.98, za kni gata *Somme` it ei nevi st i nit e za brojnost ana soprugi t ena Prorokot a.s.* se pla ja povl astena dano-na st apka.

Sipas mendimit të Ministrisë së Kulturës nr. 07-6132/2 të datës 29.10.98, për librin *Dyshimet dhe të pavërtetat rreth shumësisë së grave të Pejgamberit a.s.* bëhet pagesa e lehtësuar tatimore.

ISBN 9989-601-80-1